



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.862/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me apelin e Edona Bakolli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Edona Bakollit, kandidate për anëtarë të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, në Vendvotimin: 2508D/03R .

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e votimit, në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar apelin ZL.Anr.862/2017 me 10.11.2017, e parashtuar nga Edona Bakolli, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Ferizaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Ferizaj, në të cilën pretendon se në fshatin Graçkë, në Qendrën e Votimit QV nr. 2508D/03R , është manipuluar me vota të tij, sepse në këtë vendvotim është votuar subjekti politik PDK me nr.94 si dhe numëri imë 18 nga së paku 10 anëtarë të familjes.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve dhe manipulime të votave, të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur më lartë dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pjesën II të dispozitivit të vendimit .

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura e miratoj apelin e apeluesit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*. Nga sa u tha më sipër, në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.862/2017 më datën 12.11.2017.



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i*.